



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr.87/2017

Prishtinë, më 21.2.2017, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa, kryetar, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca, Rrustem Berisha, Enver Hoti dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Glauk Konjufca, zëvendëskryetar i parë dhe Sasha Milosavljeviç, zëvendëskryetar i dytë.

Pjesëmarrës të ftuar: Nehat Idrizi, Këshilli Gjyqësor i Kosovës; Mentor Borovci, Ministria Drejtësisë; Gëzim Bislimi, Ministra e Financave.

Pjesëmarrës të tjerë: Bajram Miftari dhe Astrit Hoti, KGJK; Baki Gimolli, MD; Bardha Tahiri, USAID; Etleva Malushaj, LVV; Dardan Abazi, INDEP; Ahmet Rushti, KDI; Arlinda Bajrami GAP.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti, Muhamet Morina dhe Nurie Morina, si dhe Leutrim Krasniqi dhe Erëza Hasani, praktikantë të Komisionit.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1.Miratimi i rendit të ditës;
- 2.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 7.2.2017;
- 3.Mbikëqryja e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit, lidhur me kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata, të datës 25.6.2015;
- 4.Shqyrtimi i Raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-130 për shërbime;
- 5.Formimi i grupit të punës për hartimin e nismës legjislative: „Ligji për miniera dhe minerale”;
- 6.Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit të ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 7.2.2017

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 7.2.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Mbikëqyrja e zbatimit të rekomandimeve të Kuvendit, lidhur me kontestet biznesore dhe adresimi i tyre ne gjykata, të datës 25.6.2015

Kryetari – Lidhur me këtë pikë, kemi folur edhe në mbledhjen e kaluar. Ne kemi analizuar përsëri çështjen e kontesteve biznesore dhe rëndësisë së tyre për përmirësimin e mjedisit për biznes dhe për tërheqjen e investimeve. Siç e dini, gjatë vitit të kaluar, ne kemi debatuar disa herë dhe pas debateve, ne kemi trajtuar këtë problem edhe në Kuvend dhe Kuvendi ka nxjerrë disa rekomandime lidhur me përmirësimin e situatës. Rekomandimet janë nxjerrë për arsye se është konsideruar me numrin e gjyqtarëve që merren me këto çështje edhe në shkallën e parë në Gjykatën Themelore, edhe në Gjykatën e Apelit, jo vetëm që nuk po zvogëlohet numri i lëndëve, por po vjen duke u rritur, prej të cilave kanë qenë 1800, tash më duket ka shkuar në 2400 lëndë. Janë 3 konkluzione të rëndësishme, pra të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që trajtimi i kontesteve biznesore të shkurtohet në mënyrë të ndjeshme, kontestet gjyqësore të zgjidhen brenda 6 muajve. Kjo po shihet se nuk ka arritur të bëhet, por sigurisht do të shohim ku jemi. I kemi rekomanduar Qeverisë, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, që të sigurojnë parakushtet e nevojshme buxhetore, për t'u arritur ky qëllim. Nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, kemi kërkuar që të sigurojë resurse të mjaftueshme për angazhimin e personelit mbështetës, duke rritur ndjeshëm numrin e gjyqtarëve, por edhe gjyqtarët të kenë bashkëpunëtorë profesionalë, që t'ju ndihmojnë dhe t'i trajtojnë sa më shpejt, 1 deri në 2 bashkëpunëtorë profesionalë, për secilin gjyqtar, në mënyrë që të rritet efektiviteti. Në mbledhjen e kaluar, këtë çështje e ka iniciuar kolegu Rustem Berisha, por të gjithë kemi menduar që të shohim se çka duhet të bëjmë të gjithë së bashku, për t'i arritur këto qëllime, për arsye se kjo është një çështje jashtëzakonisht me rëndësi, sepse bizneset nuk mund të presin me vite për zgjidhjen e problemeve të tyre, sepse atëherë pasojat për mjedisin biznesor, sigurinë juridike dhe mjedisin afarist, janë jashtëzakonisht të dëmshme.

Nehat Idrizi, kryetar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) – Falënderoj për interesimin dhe gatishmërinë që Komisioni ka shprehur, që ta ndihmojë këtë proces, sidomos Departamentin Ekonomik, në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës, që është një departament i veçantë dhe që merret me konteste të veçanta, që kryesisht kanë të bëjnë me bizneset, si brenda Kosovës, por edhe me bizneset që ndërliken nga jashtë. Në bazë të rekomandimeve që kanë dalë nga Komisioni funksional, me 9.6.2015, që janë katër për Këshillin Gjyqësor. E para, ka qenë që të reduktohet afati, gjegjësisht të shkurtohet koha e këtyre lëndëve në gjashtë muaj. Kjo, fizikisht, ka qenë e pamundur, për arsye se në këtë departament, për momentin, janë të angazhuar vetëm katër gjyqtarë. Në atë kohë, patëm kërkuar që të rritet edhe për dy dhe të bëhen gjashtë, në mënyrë që koha e kryerjes së këtyre lëndëve të shkurtohet, por faktikisht kjo nuk ka mundur të realizohet,

për shkak se Gjykata Themelore e Prishtinës është e stërngarkuar dhe është gjykata që ka peshën më të madhe, sa i përket numrit më të madh të lëndëve, edhe të lëndëve të natyrës ekonomike. Meqenëse është këtu edhe përgjegjësi i Departamentit për Çështje Ekonomike, i cili do të na informojë në detaje lidhur me këtë. Në vitin e kaluar, iu kemi drejtuar Ministrisë së Financave, me kërkesat buxhetore për Këshillin Gjyqësor, dhe në këto kërkesa, kemi paraparë edhe disa pozita shtesë të zyrtarëve ligjorë, në mënyrë që gjyqtarët të kenë një staf mbështetës profesional, i cili do ta ndihmojë gjyqtarin në punën e tij, që ai të jetë më efikas dhe në mënyrë që të realizohet edhe rekomandimi i parë. Ne jemi tani në proces të rekrutimit të 61 kandidatëve për gjyqtarë, shpresojmë që brenda një kohe shumë të shkurtër edhe këta do të dekretohen. Mirëpo, për fat të keq, me ndryshimet e reja që janë bërë në legjislacion, këta kandidatë një vit do të ndjekin trajnimin në Institutin Gjyqësor të Kosovës, dhe tek pas një viti, atëherë do të fillojnë punën. Personalisht, kjo m'u ka dukur pak e paarsyeshme, sepse të paguhet gjyqtari një vit të shkojë në trajnim dhe pas një viti të fillojë punën, do të thotë se ne duhet të presim edhe një vit, që këta të fillojnë të punojnë si gjyqtarë. Sa i përket rekomandimit të katërt, në menaxhimin e rasteve, ne kemi një fondacion nga Qeveria e Norvegjisë, që projekti i cili pritet të përfundojë në qershor të vitit 2018, sipas këtij projekti, qëllimi është të jetë gjithçka i kompjuterizuar, në njëfarë mënyrë, letra të hiqet nga përdorimi, nëse realizohet ky projekt, do të jetë jashtëzakonisht shumë në interes të madh për sistemin gjyqësor të Kosovës, do ta shpejtonte efikasitetin, shpenzimet do të zvogëlohen, mirëpo edhe do të rritej transparenca. Po ashtu, edhe sa i përket çështjes së publikimit të aktgjyqimeve, është fjala për aktgjykimin e fundit, shkrimet publikohen ndoshta jo në atë nivel, sepse të gjitha gjykatat nuk janë në nivelin e njëjtë, disa janë në hap më përpara, disa kanë ngecur pak, por në këtë drejtim, jemi duke bërë përpjekje, që të gjitha vendimet që janë të formës së prerë, të publikohen në ueb-faqen e gjykatave.

Bajram Miftari, gjyqtar përgjegjës në Departamentin për Çështje Ekonomike të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Fillimisht, besoj se është e rëndësishme edhe për Komisionin edhe për të gjithë të pranishmit, t'ju njoftojë, pak a shumë, qysh funksionon ky departament, për të pasur një qasje më të qartë. Pra, siç e përmendi edhe kryesuesi, në momentalisht, jemi duke operuar me katër gjyqtarë, kemi katër sekretare juridike dhe tre referentë, si mbështetje administrative. Po ashtu, kemi një mbështetje shumë të vlefshme nga USAIDI, me gjashtë zyrtarë, katër zyrtarë i kemi secili gjyqtar nëpër zyrë dhe dy zyrtarë të tjerë bëjnë koordinim e aktiviteteve dhe mbështetjen administrative. Për momentin, lëndë aktive kemi 1112 lëndë. Pra, ky është numri i lëndëve që presin zgjidhje në Departamentin për Çështje Ekonomike, prej tyre, 10 lëndë janë prej investimeve të huaja. Prej momentit kur filluam të startojmë me një mbështetje më të veçantë, në një divizion me investime të huaja, kanë qenë gjithsej 10 lëndë, prej të cilave 2 janë zgjidhur, në 1 lëndë është ndërprerë procedura dhe 7 lëndë jemi duke i punuar. Me mbështetjen edhe të USAID-it, me kompletimin e departamentit me katër gjyqtarë, të dhënat statistikore tregojnë se Departamenti për Çështje Ekonomike, në vitin 2016, ka startuar ose ka operuar shumë më mirë ose ka dhënë një performancë shumë më të mirë sesa në vitin paraprak 2015. Kjo shihet nga të dhënat statistikore. Në vitin 2015, kemi kryer 366 lëndë, ndërsa në vitin 2016, kemi kryer 622 lëndë. Arsyeja pse kaq pak lëndë janë kryer në vitin 2015, ka qenë se departamenti ka operuar me 2 gjyqtarë, nganjëherë me 3, më vonë me 4 gjyqtarë. Në vitin 2015, kemi pranuar 622 lëndë, ndërsa në vitin 2016, kemi pranuar 634 lëndë. Tash, kur merren për bazë këto të dhëna, shihet se në vitin e kaluar, në vitin 2016, aq lëndë sa kanë ardhur në gjykatë, aq edhe i kemi kryer. Ndërsa, në Gjykatën e Apelit, i kemi 27 lëndë, në procedurë.

Kryetari – Sipas një informate nga përfaqësuesit e USAID-it, që e përcjellin pak a shumë këtë sektor, thotë se dy gjyqtarë të Gjykatës së Apelit, që kanë qenë në moshë, kanë shkuar në pension dhe nuk janë zëvendësuar, praktikisht aty nuk është asnjë.

Nehat Idrizi – Së shpejti do të zëvendësohen.

Bajram Miftari – Më lejoni, do të jap vetëm edhe një informatë. Departamenti për Çështje Ekonomike, përveç këtyre lëndëve që i diskutuam deri tash, kemi pasur një kompetencë në bazë të ligjit të mëhershëm, pra edhe lëndët e natyrës përmbarimore. Ne kishim rreth 3000 lëndë të asaj natyre, më vonë, me ndryshimin e kompetencave, në kompetencat e Departamentit për Çështje Ekonomike, kalojnë në gjykatat tjera të vendit edhe tek përmbaruesit privatë. Për falimentimet, vetëm dy fjalë do t'i kisha thënë. Deri tani, lëndë të falimentimit kemi pas fare pak, ndoshta shifra shkon deri në 10 lëndë. Me ligjin e ri, që është miratuar në Kuvend, për falimentimin, pritshmëria është që do të ketë lëndë më shumë, duke marrë për bazë që bizneset duhet t'i kalojnë procedurat e shuarjes, gjithëherë përmes Departamentit për Çështje Ekonomike. Por, për të zvogëluar numrin e lëndëve, duhet rritur numrin e gjyqtarëve, dhe secili gjyqtar të ketë një ose dy bashkëpunëtorë profesionalë, dhe në këtë takim, falënderoj posaçërisht USAID-in, për mbështetjen e fuqishme që i ka dhënë Departamentit për Çështje Ekonomike, sepse na ka mbështetur me gjashtë zyrtarë.

Mentor Borovci, Ministria e Drejtësisë – Ne, si Ministri e Drejtësisë, për ta adresuar çështjen e këtyre rekomandimeve, me rekomandimin e dytë vlen të potencohet se i rekomandohet Qeverisë, përkatësisht ministrisë, në bazë të kompetencave ligjore, të cilat janë përcaktuar për KGJK-në. Kjo krejt bie në kompetencën e KGJK-së, si organ i pavarur. Ne kemi dërguar edhe me shkrim, edhe dispozitat ligjore përkatëse dhe për këtë nuk e kisha zgjatur më shumë, por është në kompetencën e KGJK-së, ta zbatojë këtë rekomandim.

Gëzim Bislimi, Ministria e Financave – Bazuar në këto rekomandime, unë e kam përgatitur një raport për ndarjet buxhetore, nënshpenzimin si dhe krahasimet në vitet paraprake për Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Prej këtij raporti, shihet që ndarjet buxhetore për KGJK- në, në vazhdimësi, janë rritur. Kështu, në vitin 2016, ndarjet buxhetore janë rritur për 611000 euro, në krahasim me vitin 2015, edhe për kategori ekonomike, është i përcaktuar në kategorinë e pagave dhe mëditjeve dhe kjo shumë është 1.1 milion euro, është rritja më e madhe se sa në vitin 2016. Edhe në vitet e tjera, kemi pasur rritje të buxhetit. Në vitin 2016, krahasuar me vitin 2015, kjo rritje është 1.7 milion, mirëpo ajo që duhet potencuar në këtë raport, është edhe nënshpenzimi, ku në vazhdimësi, KGJK-ja ka pasur nënshpenzim ose ka pasur suficit në ndarjen buxhetore. Ndarjet buxhetore nuk janë problem për KGJK-në. Në vazhdimësi, Qeveria dhe Ministria e Financave e kanë mbështetur gjithmonë KGJK-në, në përgjithësi, sektorin e drejtësisë dhe Prokurorinë e Shtetit edhe Ministrinë e Drejtësisë. Pra, janë këtu edhe njerëzit kompetentë dhe mund ta dëshmojnë këtë.

Besim Beqaj – Besoj që është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme, kjo që po e diskutojmë sot, marr parasysh që shpesh këto konteste apo lëndë në gjykatë apo në Departamentin për Çështje Ekonomike dhe bëhen pengesë në zhvillimin dhe qartësimin e marrëdhënieve kontraktuale në mes të kompanive. Ne kemi menduar që atëherë për të marrë vendimin për ta ndërprerë punën e Bordit për Ankesa dhe Parashtesa, i cili ka funksionuar pranë ATK-së edhe Doganës, që do të shkojmë, me përshpejtim, kështu na është dhënë një lloj konfirmimi, por që siç duket, s'ka pasur

sukses, sepse lëndët e vjetruara po na mbesin prapë në këtë sistem. Unë kujtoj që ka pasur edhe një nismë tjetër dhe besoj që Ministria e Financave është në dijeni, që edhe një herë, një numër i lëndëve të vjetruara, t'i kthehen Bordit, në mënyrë që të mbyllet dhe të vazhdohet me rritjen e kapaciteteve, duke e marrë një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme, për të cilën unë kisha kërkuar sot mendimin e juaj si KGJK. Në diskutimin që është bërë, lëndët kur të trajtohen, duhet të funksionojë parimi i dy niveleve në gjyqësi. A është duke funksionuar tash në kuadër të KGJK-së? Sepse, lëndët duhet të apelojnë, dhe lëndët të cilat apelojnë, si funksionon kjo? Është një çështje që është ngritur nga njerëz që kanë qenë pjesë e këtij Bordi të pavarur për Shqyrtim të Ankesave. Dhe, çështja e dytë, është çështja buxhetore. Besoj që duhet të themi hapur, që nuk është çështje e buxhetit, por mungesa e kuadrit. Kam qenë për dy vite ministër i Financave, 3 buxhete i kam bërë vetë dhe gjithmonë kemi pasur nënshpenzim. Pra, siç e tha edhe zyrtari i Ministrisë së Financave, nënshpenzimi, për qartësim të të gjithë këtyre, nuk është krejtësisht aq e thjeshtë, siç po e prezanton zotëria nga ministria, sepse KGJK-ja i ka disa specifika të vetat. Nënshpenzimi lidhet edhe me gjyqtarët e minoriteteve, të cilët nuk janë të plotësuar, por ka qenë dhe vazhdon të jetë. Ministria e Financave ka kërkuar gjithmonë nga KGJK-ja, kur paraqitet rasti për mbulimin e gjyqtarëve të minoriteteve, parimisht duhet njoftuar, sepse në parim, gjithmonë kemi pasur diku 300 vende të plotësuar nga gjykata, tash çështja mbetet në mes të asistentëve dhe gjyqtarëve se si do të zgjidhet kjo procedurë. Nuk kemi të bëjmë asgjë me Ministrinë e Drejtësisë, është plotësisht e vërtetë, sepse duhet njëfarë orientimi, se çfarë duhet t'i japim në këtë çështjeje. Pra, 1001 lëndë, të cilat duhet të na paraqiten realisht, gjithmonë, do t'i kemi me 2 vjet lëndë të vjetruara, në mesatare për biznes. Çka po ju dërgojmë bizneseve, çfarë mesazhi? Ne po ju dërgojmë mesazh të qartë, që hyni bëni probleme, lejoni ato raporte, 2 vjet nuk ju prek askush, sepse e bëjmë njëfarë logjike të funksionimit të lëndëve, sipas renditjes, domethënë 2 vjet, mbas 2 vjetëve ajo punë kryhet. Domethënë, bizneset mund të falimentojnë apo mund të rezultojnë me diçka tjetër. Unë besoj se është jashtëzakonisht e rëndësishme dhe është urgjente. Nëse prapë është çështje buxhetore, Komisioni për Zhvillim Ekonomik do të ulet bashkë me ju, bashkë me Ministrinë e Financave dhe ta ngremë në rishikim buxhetor prapë, por është mirë që të na shpjegohet një 1.2 milionë për 2016, 300 vende të paplotësuar, prapë kjo lidhet me veriuin, dhe unë e di, edhe ju e dini që Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë dhe të gjithë, por gjithmonë e kemi pasur atë miratimin e Ministrisë së Financave, që në rast se juve iu paraqitet, me urgjencë, nevoja për gjyqtarë të komuniteteve, ne do të veprojmë nga rezervat. Kështu, së paku, unë kam vepruar kur kam qenë ministër, në mënyrë që ta lejojmë që kjo të kryhet, por nuk duhet të jetë çështje buxhetore dhe besoj që këtë çështje duhet ta trajtojmë. Po e marrim përsipër, si Komision, unë, personalisht si ish- ministër dhe si person përgjegjës në parti politike, për çështje buxhetore dhe ekonomike, që ne duhet të angazhohemi që ta bëjmë, por ta qartësojmë a është kjo çështje e buxhetit. Nuk e di kryetar, nëse të kujtohet mirë, ne kemi kërkuar që të matet performanca dhe kompetenca e gjyqtarëve që merren me çështje ekonomike. Pra, paraprakisht për të pasur një trajnim të gjyqtarëve, që merren me çështje ekonomike, por nuk mund t'i marrim njerëzit, të cilët janë marrë me lëndë civile apo penale dhe tash të vendosin për çështjet ekonomike.

Nehat Idrizi – Unë nuk dua të kthehem tash në të kaluarën, por prej momentit kur unë e kam marrë këtë pozitë dhe kur e kam kuptuar se vërtet është një numër prej 61 gjyqtarëve të paplotësuar në nivelin themelor, 4 në Supreme, për mua ka qenë shqetësuese dhe menjëherë kam ndërmarrë hapat që të shpallet konkursi dhe të plotësohen. Tani kemi në procedurë afër 70 pozita, 61 në Themelore, 4 në Apel dhe 2 në Supreme. Edhe çështja e veriut që u përmend, që kanë qenë

d.m.th. të paplotësuara. Sa i përket investimeve që ka pasur të bëjë me investitorë të huaj, në muajin qershor të vitit të kaluar iu kam drejtuar Gjykatës Themelore të Prishtinës, Pejës dhe Gjakovës. Aty ku kam pasur të dhëna se i kanë disa konteste, ku palët janë investitorë të huaj apo bashkatdhetarët, kemi kërkuar shpejtimin e procedurës. Tash e di që disa gjykata i kanë dhënë prioritet dhe kanë filluar t'i shpejtojnë këto raste. Këto pozita, pritet që shumë shpejt të plotësohen, sidomos këto në Themelore, sepse Gjykata Themelore e Prishtinës është në gjendje jashtëzakonisht të rëndë, pastaj vjen edhe ajo e Apelit.

Raif Qela – Konkretisht, për Departamentin e Çështjeve Ekonomike, a keni parashtruar konkurs apo jo?

Nehat Idrzi – Po, tash jemi në fazën e finalizimit, d.m.th shumë shpejt pritet që emrat të dërgohen te Presidenti për dekretim. Besoj që brenda muajit, do të dërgohen. Sa i përket Bordit të Ankesave, thashë që gjyqtari përgjegjës Miftari, mund të japë ndonjë sqarim.

Kryetari – Vetëm edhe një pyetje, parimisht këto lëndë që kanë të bëjnë me kontestet biznesore, si qëndron situata me vjetërsimin e tyre?

Bajram Miftari – Këto lëndë nuk janë lëndë që vjetërsohen. Në momentin kur lënda hyn në gjykatë, çdo afat i vjetërsimit apo parashkrimit ndërpritet, kështu që pala është e sigurt që nuk ka parashkrim. Çështja e Bordit që e përmendi zotëri Beqaj, po ashtu përmendi çështjen e apelimit sesi qëndron. Kompetencat që i kanë takuar këtij Bordi, tash janë kompetenca të Departamentit për Çështje Administrative, në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, domethënë nuk është në kompetencë të ekonomikes. Ne jemi departament biznesor, përfundimisht nuk jemi departament që bëjmë mbikëqyrjen ndaj organeve administrative. Edhe çështja e apelimit, konsideroj se është shumë në rregull, d.m.th. funksionon parimi dyshkallësh, sepse edhe në Gjykatën e Apelit e kemi kolegjin për çështje administrative. Çështjen e investimeve të huaja që i kishim 10 lëndë, ne jemi duke u munduar për t'i kryer këto lëndë me prioritet, 3 prej tyre janë kryer, por këto lëndë, zakonisht njëri prej bizneseve që zakonisht paditësi është nga bota e jashtme në komunikim me gjykatën me botën e jashtme, është bukur i vështirë. Janë disa rregulla që 6 muaj përpara duhet të dërgohet thirrje për seancë, duhet të bëhet përkthimi në çfarëdo gjuhe që të jetë pala, e kështu me radhë.

Fatmir Rexhepi – Takimi i karakterit informativ për çështjen që e kemi ngritur, që është më shumë rëndësi për kontestet biznesore, të cilat kanë paraqitur një sfidë pak më specifike në natyrën e zgjidhjes edhe brenda departamenteve të Këshillit Gjyqësor, mendoj që sot nga ky takim edhe nga kjo informatë që e dha edhe kryetari, edhe përfaqësuesi i departamentit, personalisht për mua, e kemi pak më të qartë agjendën, dinamikën e punës që është bërë brenda kësaj periudhe. Unë jam i kënaqur me këtë informatë, të cilën e dhanë të dy, këtu para neve dhe e kam një shpresë që janë duke bërë një punë të mirë. Në kuadër të prioritetëve që i kanë shtruar në mes këtyre pasqyrave, që u thanë këtu, në vitet 2015-2016, u pa se është rritur zgjidhja e lëndëve të bizneseve apo kontesteve biznesore. Pra, ky është tregues shumë i mirë dhe këta janë shumë afër nesh, për të parë se cilët do të jenë hapat, brenda këtij viti, që duhet edhe më tej t'i kenë, si prioritet, brenda organizimit të brendshëm, në kuadër të kompetencave që i kanë. Mendoj që gjatë vitit 2017, kryetari dhe kolegët tjerë që i ka aty, do të kisha kërkuar, bie fjala, që vetë kryetari me stafin e vet le ta bëjë organizimin e ri ose planin e veprimit të ri, për zgjidhjen e këtyre kontesteve

biznesore, që i përmendën këtu. Pra, për mua është me rëndësi, dhe do të kërkoj nga kryetari, që ta kenë një plan veprimi për zgjidhjen e këtyre kontesteve biznesore. Tash, a është në pyetje numri i gjyqtarëve, a është në pyetje numri i stafit, a është në pyetje numri i bashkëpunëtorëve apo buxhetit? Unë mendoj se ne nuk kemi asgjë në dorë për atë punë, përveç informatave që na i jepni. Por, meqenëse i keni kompetencat e plota, do ta keni edhe përkrahjen e plotë edhe të Kuvendit, edhe të ministrisë. Po ashtu, besoj se tash është një mundësi e re, një mundësi e madhe për ju dhe shpresoj që do ta bëni këtë, për të parë paketën për zgjidhjen e lëndëve nga e kaluara, si dhe përcjelljen e dinamikës së lëndëve të tjera. Pra, shpresoj se me këtë ritëm, që e keni ndërruar prej 2012 deri në 2016, mua më jep një pamje tjetër, për të cilën iu përkrahu.

Blerim Grainca – Parimisht, pothuajse u shteren të gjitha problemet, të cilat i kemi ngritur këtu, edhe na ngeli pak për të thënë. Megjithatë, mendoj që, përveç çështjeve financiare dhe çështjeve që lidhen me numrin e gjyqtarëve, një ndër problemet që ka qenë, ka qenë edhe organizimi i brendshëm apo një lloj burokracie që i ka zvarritur nga pak lëndët. A mund të shpresojmë, që me një koordinim më të mirë të brendshëm edhe në mes të institucioneve, por edhe brenda gjykatave, me një delegim më të shpejtë të detyrave dhe të përgjegjësive, mund ta rrisim performancën. Kjo do të ishte një tregues se statistikave që u dhanë këtu, në mes të viteve 2015 dhe 2016, ka pasur përmirësim, dhe tregon që me një ndryshim të vogël, janë rritur performancat. Prandaj, mendoj se edhe tek faktori njeri, qëndron pak problemi, po ashtu te menaxhimi i brendshëm. Ju inkurajoj që në këtë fushë, të bëhet më shumë.

Enver Hoti – U thanë këtu nga kolegët deputetë, disa çështje të rëndësishme. Ne i dëgjuam me vëmendje përfaqësuesit e gjyqësorit. Do të doja vetëm të potencoj se me të vërtetë ka një dekurajim të çështjeve, sa i përket bizneseve që kanë hasur në problematika të tilla. Po ashtu, do ta veçoja një gjë. U tha se për shkak të numrit të kufizuar të gjyqtarëve dhe kufizimeve buxhetore, ndoshta kanë mbetur lëndë pa u trajtuar, por lëndët të cilat kanë filluar në procedurë dhe dinamika e tyre shkon me vite. Po ashtu, nuk na thatë sa është numri i tyre dhe një afatin, ku lënda ka ngecur, sepse zvarritja e këtyre procedurave është e rëndë dhe paraqet një mos-seriozitet, kur fillon procedimi i asaj lënde. Mendoj që u thanë se janë 10 lëndë të kontesteve të investimeve të huaja, ku janë zgjedhur vetëm 2. Kjo është joserioze dhe ne nuk mund të flasim tani për raste konkrete, por si opinion paraqet një dekurajim, së paku me gjendjen në investimet e huaja, është një çështje e cila ndikon shumë në këto investime, për të cilat, ne e dimë çfarë rëndësie kanë dhe si duhet të trajtohen.

Rrustem Berisha – Herën e kaluar, kur e kemi iniciuar këtë çështje, madje për pamundësinë se si mund ta përshpejtojmë zgjidhjen e këtyre kontesteve biznesore, sepse ka shumë ankesa të kompanive të bizneseve, për vonesat që po ndodhin në zgjidhjen e këtyre lëndëve edhe për krijimin e një ambienti sa më të përshtatshëm për biznese. Po ashtu, u tha dhe u informuam se si janë zgjedhur kontestet biznesore në vitet 2015-2016. Po shihet qartë se në vitin 2016, ka rritje të zgjidhjes së këtyre kontesteve, por kam pasur rastin të takoj kryetarin e Gjykatës Themelore për çështje të një ligji për AKI-në. E theksoi edhe z. Idrizi, që barrën kryesore e bart Gjykata Themelore për zgjidhjen e këtyre lëndëve, i cili e kishte një propozim të mirë, ku ndoshta nuk do të ishte keq të bisedohet, që të ristrukturohet kjo gjykatë. Sepse, aty shkojnë të gjitha lëndët e natyrave të ndryshme, me qëllim që të krijohet hapësira dhe të gjendet një formë që mund të gjendet, që të përshpejtohen këto lëndë. U tha edhe nga deputetët, që çdoherë këto 100 lëndë do të na përcjellin, në rast se nuk marrim masa shtesë.

Bardha Tahiri, këshilltare ligjore nga USAID-i, programi për legjislacion dhe përmbarim komercial – Vlen të theksohet se mbështetja e USAID-it, konkretisht programi për përmbarim dhe legjislacion komercial, Departamenti për Çështje Ekonomike në Gjykatën Themelore të Prishtinës, ka filluar në shtator të vitit 2015. Pra, jemi aty me mbështetjen që konsiston në mbështetje ligjore, ku brenda zyrës, secili gjyqtar, me nga një bashkëpunëtor profesional, me dy persona të tjerë, staf mbështetës në administratë, konkretisht në menaxhimin e lëndëve që ndryshe njihet edhe si regjistër. Vitin e kaluar kemi filluar me mbështetjen e Departamentit për Çështje Ekonomike në Gjykatën e Apelit, me 3 bashkëpunëtorë profesionalë. Vlen të theksohet se ndoshta, gjendja aty, po pajtohem plotësisht me kryesuesin, që është me të vërtetë shumë e rëndë. Ka lëndë shumë dhe prioritetin e dinë ata më së miri, se si kanë do të bëjnë destinimin e këtyre gjyqtarëve të rinj. Në Gjykatën e Apelit, përkundër asaj që procedura kërkon që të jenë 3 gjyqtarë për vendimmarrje, aty tani është vetëm 1 gjyqtar në Departamentin për Çështje Ekonomike, por në diskutim edhe me kryetarin e ri, tash dhe janë marrë hapat për t'u plotësuar. Në Gjykatën Themelore të Prishtinës, i kemi 4 gjyqtarë, 4 bashkëpunëtorë profesionalë, që ofrohen prej programit të USAID-it, dhe siç tha edhe kryesuesi i departamentit, shihet një rritje, por programi ynë, edhe ai e ka një kohëzgjatje, kështu që e kemi diku pak më shumë se 1 vit, që kemi ofruar mbështetje. Qëllimi ynë është ta transferojmë këtë mbështetje që e kemi ofruar dhe këtë praktikë që e kemi, që të kemi një qëndrueshmëri të këtij sistemi. Programi ynë ka ofruar edhe trajnime, sepse e përmendi deputeti punën e trajnimeve dhe profilizimin e gjyqtarëve në këtë lëmi, kemi qenë gjithmonë të vetëdijshëm për këtë dhe prej fillimit programi për përmbarim dhe legjislacion komercial, ka qenë i fokusuar në bashkëpunim shumë të ngushtë me Institutin Gjyqësor të Kosovës, për trajnimet e ofruara, konkretisht për fushat komerciale dhe tash jemi në fazën, ku veç i kemi transferuar në të gjitha këto trajnime, praktikat që i kemi pasur deri më tash.

Bajram Miftari – Deputeti që e parashtrori çështjen, që në këtë departament lëndët duhet të punohen me kujdes, nuk them që në departamentet tjera duhet të punojnë shkel e shko, por janë lëndë të natyrës së ndërlikuar, shpeshherë janë lëndë me konteste milionëshe. Po ashtu, gjyqtari duhet të jetë tepër i kujdesshëm, në çdo veprim që e ndërmer, përndryshe mjafton, unë ose kolegu im, gjatë vitit, tri lëndë të punohen gabim dhe pasojat janë shumë të larta. Për këto lëndë, nganjëherë duhet mbajtur nga 10 deri në 12 seanca, derisa të arrish në përfundim. Po ashtu, këto lëndë shpeshherë shkojnë në ekspertiza të natyrave të ndryshme financiare, shkojnë nganjëherë edhe në ekspertizë të tekstit etj. Rekrutimi i gjyqtarëve të rinj, ne i kemi tash 61 gjyqtarë që u përmend shumë mirë rekrutimi dhe cilësia, mirëpo varet edhe prej një elementi, që hiq nuk më vjen keq ta them, ai element është paga. Kuvendi i Kosovës duhet të llogaris, si institucion legjislativ i vendit, çfarë pagesa i kanë gjyqtarët dhe sa mund t'i inkurajosh të rinjtë që të aplikojnë dhe për t'u bërë gjyqtarë. Në Pallatin e Drejtësisë, nganjëherë kemi raste kur duhet ndërprerë seancën ose së paku kur ta përfundojmë seancën, unë edhe sekretarja duhet të dalim jashtë për të marrë ajër, sepse nuk e dinë a ka oksigjen apo jo. Në këto kushte po punojmë, pra në kushte të papërshtatshme.

Besim Beqaj – Nisma për arbitrazh dhe trajtimi i arbitrazhit në fuqi ligjore, nga momenti kur arbitrazhi e njej vërdiktin e vet, a është duke u shfrytëzuar si e tille? Edhe çështja e dytë, investimet e huaja dhe prioritetet, të them të drejtën, duhet të jemi shumë të kujdesshëm kur i prioritetizojmë, a duhet të prioritetizohen ato lëndë apo jo? Unë kam dilema, a duhet prioritetizuar

lëndët, të cilat janë prej investimeve të jashtme, sepse fundi i fundit, ne duhet trajtuar të gjithë investorët, në mënyrë të barabartë, ndoshta lëndët tona janë më të rëndësishme sesa ato të huajat.

Raif Qela – Informatat, të cilat i dëgjuam sot prej përfaqësuesve të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, janë shumë shpresëdhënëse. Këto informata flasin se në këtë vend ka shpresa për investime, se po krijohet klimë e volitshme për investime, dhe sa më shumë që të jenë efikase edhe lëndët gjyqësore, aq më mirë do të jenë, në përgjithësi, bizneset. Prandaj, e përkrahu punën që është duke e bërë Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe i inkurajoj ata, që të jenë më të vendosur, në mënyrë që t'i ndërmarrim të gjitha masat, që të mos ketë grumbullim të lëndëve dhe shpresoj që pas një viti, mos të ketë më lëndë të vjetra më shumë se 1 vit.

Sala Berisha-Shala – Faleminderit kryetar, shumë shkurt, 10 lëndë të investimeve të huaja, 3 janë zgjedhur. Më intereson ta di, sa është vjetërsia e këtyre lëndëve? E marr me mend, se ju thatë duhet 6 muaj përpara për t'i njoftuar investorët e jashtëm. Pajtohem me konstatimin e z. Beqaj se prioritetizimi duhet të jetë, varësisht nga rëndësia e këtyre investimeve. Prapë mendoj se ndoshta janë të përcaktuara me ligj, se cilave lëndë duhet t'ju jepet prioritet, por sidoqoftë trajtimi i lëndëve që vijnë nga investimet e huaja, ndoshta do të rregullonte edhe një imazh të bërit biznes këtu në Kosovë dhe do të ishte një çështje me rëndësi.

Bajram Miftari – Ne nuk i kemi të dhënat se këto 7 lëndë, të cilat kanë mbetur, cilit vit i takojnë, mirëpo, përgjithësisht, ne i kemi të dhënat që lëndë të vitit 2011 ka mbetur 1 lëndë e pakryer; 2012 13 lëndë; 2013 – 48 lëndë; 2014 i kemi edhe 111 lëndë të pakryera; 2015, janë 326 lëndë; 2016, janë 523 lëndë të pakryera. Arsyeja pse 1 lëndë ose 13 lëndë, për arsye se nganjëherë lënda jonë varet nga një lëndë tjetër e natyrës penale dhe është në diskrecionin e gjyqtarit për të ndërprerë procedurën dhe për të pritur epilogun e procedurës penale, kështu që është e pamundur të bëhet numri zero. Edhe çështja e arbitrazhit, mendoj se është një çështje shumë e rëndësishme që e ngriti deputeti Beqaj. Lidhur me kompetencat në çështje të arbitrazhit, ju e dini që ky Kuvend, veç e ka sjellë Ligjin për arbitrazhin, në vitin 2007. Meqenëse ai ligj është aq i vjetër, pra është i kohës së institucioneve të përkohshme të qeverisjes, është mirë që të ri-draftohet, sepse ne si gjyqtarë po konsiderojmë se duhet të ndodhë një gjë e tillë. Kompetencat e gjyqësorit, në çështjet e arbitrazhit, iu kanë lënë Departamentit për Çështje Ekonomike, d.m.th. ai e bën mbështetjen e arbitrazhit, por edhe mbikëqyrjen, në suaza të atij ligji.

Nehat Idrizi – Vetëm desha të ndërlihem me z. Beqaj, rreth qasjes së trajtimit të barabartë të palëve. Vërtet, palët duhet të trajtohen të barabarta në procese, por ligji parasheh disa prioritete, pra disa lëndë me prioritet. Ne kemi pasur një nga Ministria e Diasporës, për disa lëndë që kanë të bëjnë me investimet e huaja. Pra, përderisa i ftojme investorët e huaj për investime në Kosovë, atyre duhet vërtetuar se vërtet ne do të jemi efikas, nëse ata kanë ndonjë problem. Asnjë investor i huaj nuk dëshiron të investojë në asnjë vend, e as në Kosovë, nëse ai paraprakisht e di që nëse e ka një kontratë në kontest dhe kontesti i tij do të zgjatë me vite. Ne kemi pasur disa takime, më herët dhe jemi munduar të gjejmë modele sesi të forcohet ky departament, që bizneset që kanë konteste, të zgjidhen në afat sa më të shpejtë dhe të arsyeshëm dhe në mënyrë të drejtë e meritore.

Kryetari – Mund të konstatojmë se kemi pasur disa lëvizje pozitive në zbatim të rekomandimeve, është rritur produktiviteti në trajtimin e lëndëve, d.m.th. numri i lëndëve është dyfishuar, në krahasim me vitin 2015. Megjithatë, numri prej 4 gjyqtarëve nuk është i vogël dhe nuk mund të bëjmë vërejtje që gjyqtarët nuk kanë trajtuar lëndët, është vështirë të mbahet ky ritëm. Prandaj,

ne e konfirmojmë kërkesën tonë, si Komision, që ju të rrisni numrin e zyrtarëve dhe t'i përgatisni bashkëpunëtorët e rinj, në mënyrë që të stabilizohet situata, që shqyrtimi lëndëve të mos zgjasë mbi 6 muaj, sepse trajtimi 1-2 vite, po i dekurajon bizneset, duke e dëmtuar rëndësinë që kanë bizneset në zhvillimin ekonomik. Këshilli Gjyqësor, nëse ka probleme me buxhetin, ftohen të vijnë në qershor, kur bëhet rishqyrtimi i buxhetit dhe Komisioni do të bëjë amendament për ndarje të buxheti, sepse është kostoja më e madhe, duke mos trajtuar lëndët lidhur me kontestet biznesore, që janë investimet në zhvillimin biznesor, prandaj e kemi mbështetjen tonë që të mbërrihet ai objektivi në rritjen e kapacitetit që kemi në dikaster. E dyta, natyrisht që janë përcaktuar disa prioritete me ligj për investitorët e jashtëm. Parimisht, ju kishim sugjeruar, duke ruajtur atë për investitorët e jashtëm, të mos diskriminohen investitorët e brendshëm, sepse në fund të fundit, janë ata që do të kthejnë zhvillimin ekonomik.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Komisioni realizoi mbikëqyrjen e rekomandimeve të Kuvendit, lidhur me kontestet biznesore dhe adresimi i tyre në gjykata, të datës 25.6.2015.*
- 2. Komisioni vlerëson se ka lëvizje pozitive në zbatim të rekomandimeve, sepse është rritur produktiviteti në trajtimin e lëndëve në gjykata.*
- 3. Komisioni e mbështet dhe e inkurajon Këshillin Gjyqësor të Kosovës, që të marrë masat për shtimin e numrit të gjyqtarëve dhe të arrijë optimumin, që brenda 6 muajve, të zgjidhet kontesti në procedurë.*
- 4. Komisioni, po ashtu, e mbështet Këshillin Gjyqësor të Kosovës, sa i përket aspektit buxhetor, në mënyrë që të arrijë objektivat e tij.*

5. Shqyrtimi i raportit me rekomandime për Projektligjin nr.05/L-130 për shërbime

Kryetari – Të gjitha komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar raportin me amendamente të Projektligjit nr.05/L-130 për shërbime dhe nuk kanë dhënë vërejtje apo komente, andaj kërkoi që të votohet raporti me rekomandime, në mënyrë që të shkojë në procedurë në lexim të dytë, në Kuvend.

Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

Përfundim

- 1. Miratohet raporti me rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-130 për shërbime.*
- 2. Raporti me rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.*

5. Formimi i grupit të punës për hartimin e nismës legislative: „Ligji për miniera dhe minerale”

Kryetari – Siç e dini, këtë çështje e kemi trajtuar 2-3 herë dhe ka mbetur që grupi nismëtar të takohet si këshill konsultativ, me përfaqësuesit e gjitha institucioneve, që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për miniera dhe minerale.

Sala Berisha –Shala – Kemi mbajtur një takim, ku kanë qenë prezent të gjitha palët e ftuara, përpos përfaqësuesit të Zyrës Ligjore të Kryeministrit, që nuk ishin të pranishëm në takim. Të gjitha diskutimet kanë qenë që të shkohet më hartimin e Ligjit të ri për miniera dhe minerale. Lidhur me këtë, kërkoi që të angazhohet një ekspert i fushës së minierave dhe mineraleve, në mënyrë që ta ndihmojë punën e grupit të punës për hartimin e nismës legislative. Po ashtu, theksoi se do të jenë në dinamikën e punës, në bazë të planit të veprimit dhe agjendës, që pritet të hartohet nga grupi i punës.

Pas debatit, Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

V E N D I M

- 1. Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, do të hartojë Projektligjin për Miniera dhe Minerale.*
- 2. Themelohet grupi i punës, në këtë përbërje: Sala Berisha – Shala, kryesuese, Besim Beqaj, Raif Qela, Blerim Grainca, Rrustem Berisha dhe Enver Hoti, si bartës i procesit të hartimit të projektligjit.*
- 3. Grupi i punës do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, si dhe mekanizmat tjerë për hartimin e këtij projektligji.*
- 4. Secili anëtar i Komisionit, sipas interesimit, mund t'i bashkëngjitet grupit të punës, gjatë punës së tij.*
- 5. Grupi i punës, në bashkëpunim me Njësinë koordinuese të Komisionit, do të hartojë planin e veprimit dhe pastaj të përgatisë raportin me shkrim, për shqyrtim dhe miratim në Komision.*
- 6. Shpenzimet për punën e grupit të punës për zbatimin e këtij vendimi, mbulohen nga buxheti i Komisionit, respektivisht nga buxheti i Kuvendit.*

5. Të ndryshme Çështjet vijuese

Kryetari– I njoftoi anëtarët e Komisionit, për çështjet që janë iniciuar nga mbledhja e kaluar, se Zyra e Rregullatorit për Energji e ka dërguar një informatë të shkurtër, lidhur me ndërprerjen e rrymës. Po ashtu, kemi biseduar për anëtarësimin e KOSTT-it në ENTSO-E, dhe për këtë çështje, do të kërkojmë informatë. Ndërsa, për ndërtimin e termocentralit “Kosova e Re”, që është kërkuar informatë se a ka filluar ndërtimi i termocentralit “Kosova e Re”, ende Ministria për Zhvillim Ekonomik, nuk e ka dërguar informatën.

Raif Qela – E informoi Komisionin për takimin që është mbajtur me të gjithë përfaqësuesit, që kanë të bëjnë me harmonizimin e Ligjit për kundërvajtje dhe Ligjit për rregullat e trafikut rrugor.

Këtë grup të punës e ka udhëhequr Armend Zemaj, nga Komision për Legjislacion dhe ankesat e të gjithë përfaqësuesve të subjekteve ishin se këtu, në këtë ligj, respektivisht nga kundërshtia që është ndërmjet ligjit të miratuar së voni për kundërvajtje dhe Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, ka probleme të mëdha në terren, si pasojë e kësaj, duhet që këto dy ligje të harmonizohen. Përfaqësuesi i Komisionit për Legjislacion u përpoq që fshehurazi që të mos e tregojë faktin se pikërisht, ai komision është shkaktar që nuk ka ardhur deri te harmonizimi i këtyre ligjeve. Unë ua thashë troç se ne ju kemi drejtuar të gjitha komisioneve, mandej u thashë se ka qenë përfaqësuesi i Komisionit për Legjislacion, në grupin e punës, se ne ju kemi dërguar të gjitha komisioneve që projektligjin ta shqyrtojnë, se a është ne kundërshtim me ndonjë prej projektligjeve të tjera, se nuk kemi marrë asnjë vërejtje të natyrave të tilla. Po ashtu, grupi i punës i projektligjit për Rregullat e trafikut rrugor dhe Komisioni ka vlerësuar se dënimet më të larta se 60 euro, është i palogjikshëm që të jepen nga ana e policëve, sepse ata, në fund të fundit, nuk i dinë rrethanat lehtësuese dhe rënduese, si edhe kjo nuk ka logjikë. Mandej, këtu e shtrova çështjen sesi duhet të rregullohet, por në fund, takimi përfundoi pa përfundime. Unë isha këmbëngulës se dënimin që mund të japë polici i trafikut rrugor, të mos jetë më e lartë se 60 euro dhe se për këtë është e nevojshme të ndryshojë Ligji për kundërvajtje, e jo Ligji për rregullat e trafikut rrugor, dhe për arsye, ka mundësi që kjo dispozitë të jetë në kundërshtim edhe me të drejtat e njeriut, qysh pretendon edhe Avokati i Popullit në takimin që ka pasur me Gjykatën Kushtetuese.

Blerim Grainca – Propozoi që të ftohet në takim ministri i Financave, për ta diskutuar bashkërisht pakon fiskale në aspektin e zhvillimit ekonomik. Kërkoj që të këtë informatë lidhur me zbatimin e konkluzioneve, nga takimi i përbashkët që e ka pasur Komisioni, me Komisionin homolog të Kuvendit Republikës së Shqipërisë, për t'u njoftuar për marrëveshjet që kemi rënë dakord, që t'i bëjmë e që të realizohen në praktikë.

Kryetari – U pajtua që të ftohet ministri i Financave, për të na njoftuar se në cilën fazë janë të hartimit të pakos fiskale. Ndërsa, sa i përket bashkëpunimit me Republikën e Shqipërisë, edhe në mbledhjen e kaluar, ju njoftova lidhur me këtë çështje, kam pasur edhe një kontakt me ambasadorin e Shqipërisë, i cili është i interesuar që t'i zgjidhim këto çështje. Me këto çështje, gjithashtu, kam biseduar edhe me zëvendëskryeministrin Ramiz Kelmendi dhe besoj që duhet t'i evidentojmë këto tri a katër çështje, që t'i shtyjmë dhe t'i zgjidhim, në të ardhmen e afërt.

Rrustem Berisha – Kërkoj që të njoftohet lidhur me tërheqjen e Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës, nga Qeveria.

Kryetari – Për tërheqjen e Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës, e kemi pasur një njoftim nga ana e Qeverisë, që na ka informuar, me shkrim, për tërheqjen e projektligjit, por për këtë çështje, sugjeroj të bëni pyetjeje parlamentarë, ku mund të njoftoheni më shumë.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa